



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Shkodër, më 14/10.2024

Nr. 681/1prot.

LËNDA: Mbi vendimin Nr.73 datë 27.09.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT TË BASHKISË VAU-DEJES.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 datë. 2.10.2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, neni 56 i KPAD, në mbështetje të nenit 3, neni 10, neni 12, neni 14/5, neni 54/n, neni 55/2 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", VKM Nr.435 datë.26.06.2024 Për një shtesë në VKB Nr.867 datë.10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit me institucionet e administratës shtetërore", shkresës Nr.680/2.prot datë.16.09.2024 të ASHK-së "Përcjellje e marëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau-Dejës", materialit të dërguar nga Sekretari e Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.5968.Prot datë.2.10.2024, Analizoi VKB Vau-Dejës Nr.73 datë.27.09.2024: "Mbi miratimin e marëveshjes së bashkëpunimit Nr.10860/1prot datë.13.09.2024, për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe kordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau-Dejës, në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje".
Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 73 Datë. 27.09.2024

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit Nr.10860/1 Prot. Datë 13.09.2024, për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës, në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje”

Në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; “Kodin Civil i republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; Ligjin Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSHP” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 3, neni 14, neni 15, neni 17, neni 19; Ligji Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24; VKM-në Nr.435, datë 26.06.2024 për një shtesë në Vendimin Nr.867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit të institucionet e administratës shtetërore”, Këshilli Bashkiak Vau Dejës:

VENDOSI :

1.Miratimin e Marrëveshjes Nr.10860/1 Prot, datë 13.09.2024 “Për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi” (Bashkëngjitur shkresa përcjellëse e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK dhe Bashkisë Vau Dejës Nr.10680/2 prot, datë 16.09.2024)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për krijimin e strukturës së përkatëse që do ndjekë në vijim këtë proces.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika 6, e ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.



Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

Miratuar me...19.....vota

Vota pro 19.

Vota kunder

Vota Abstenim

Zbardhur me date 02.10.2024

Sekretari Këshillit

Ardian Çelepija



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. ___ Prot

Vau Dejës, __. __. 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. 55 Datë. 23.09.2024

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NR.10860/1 Prot,
DATË 13.09.2024, PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËPUNIMIT,
NDËRVEPRIMIT DHE KOORDINIMIT MIDIS ASHK-së DHE BASHKISË VAU
DEJËS NË KUADËR TË PROÇESEVE TË PAPËRFUNDUARA PËR LEGALIZIMIN
E NDËRTIMEVE PA LEJE”**

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; “Kodin Civil i republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; Ligjin Nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 3, neni 14, neni 15, neni 16, neni 17, neni 18, neni 19; Ligji Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24; VKM-në Nr.435, datë 26.06.2024 për një shtesë në Vendimin Nr.867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit të institucionet e administratës shtetërore”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës ___/___/2024 të Këshillit të Bashkisë:

VENDOSI :

1.Miratimin e Marrëveshjes Nr.10860/1 Prot, datë 13.09.2024 “Për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin,e proçeseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të proçedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi” (Bashkëngjitur shkresa

rcjellëse e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ASHK dhe Bashkisë Vau Dejës Nr.10860/2 prot, datë 16.09.2024)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për krijimin e strukturës së përkatëse që do ndjekë në vijim këtë proces.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika **6**, e ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Nr. 5242/prot. Datë 02.092024

Nr. 1086/prot. Datë 13.082024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

“Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje”

e lidhur mes

“Agjencia Shtetërore e Kadastrës” (që këtu e më poshtë do të quhet “ASHK”), me seli në Tiranë, Rruga “Dora D’Istria”, person juridik publik, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Znj. Lorena Goxhobelli.

dhe

“Bashkia Vau Dejës”, me NIPT: K567050070, person juridik publik, përfaqësuar nga Kryetari Z. Kristian Shkreli, mbajtës i mjetit të identifikimit me nr. I61121058Q.

Të dyja së bashku të referuara më poshtë si “Palët”;

të ndërgjegjshëm për rëndësinë e trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë si dhe të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave administrative;

të ndërgjegjshëm se përfshirja e bashkive në procese që lidhen me administrimin e territorit mundëson zbatimin më efikas të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe është më pranë qytetarit;

palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.



Neni 2

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:

- VKM-në nr.435, datë 26.6.2024 për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” (që këtu e më poshtë do të quhet VKM)
- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
- Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar
- Ligjin nr. 111/2018, “Për Kadastrën”;
- Ligjin nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar
- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 14, neni 64 germa “gj”;
- Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24;
- Ligjin nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit të Bashkisë, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Neni 4

Parimet e bashkëpunimit

Zbatimi i bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje realizohet në respektim të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore, të ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5

Mënyra e bashkëpunimit

Në kuadër dhe në zbatim të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, palët angazhohen të bashkëpunojnë, bashkëveprojnë dhe koordinohen në lidhje me sa vijon:

- të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për proceset tranzitore.
- të komunikojnë, bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtarinë administrative ndërmjet tyre në funksion të realizimit të kësaj Marrëveshje;



- të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, përcaktojnë planin e veprimit si dhe grafikun e prioriteteve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- Bashkia ndihmon zyrën e ASHK-së duke transferuar fond me terma dhe specifikime të veçanta, ky fond në favor të ASHK-së përdoret vetëm për të mbuluar shpenzimet e pagave të stafit shtesë pranë zyrës së ASHK-së, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në këtë rast, për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes, stafi në fjalë i nënshtrohet procedurave ligjore të punësimit, sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për kadastrën.
- të informojnë Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes dhe Vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar me VKM-në nr.435, datë 26.6.2024 për një shtesë në VKM-në nr. 867, datë 10.12.2014.
- të bashkëpunojnë për realizimin sa më efikas, transparent dhe profesional të procesit administrativ në çdo formë tjetër që vlerësohet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Angazhimet e palëve

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës në zbatim të kësaj Marrëveshje angazhohet të kryejë si vijon:

- Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe evidentimin e kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.
- Të organizojë dhe caktojë stafin e drejtorisë vendore të ASHK-së në territorin e së cilës ndodhen nënzonat e propozuar nga Bashkia, në funksion të realizimit të këtij procesi me volumin e kërkesave.
- Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpenzimin e fondit të transferuar nga Bashkia sipas përcaktimeve të VKM-së dhe kësaj Marrëveshje. Të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me punësimin e stafit të specializuar pranë ASHK-së për periudhën e kohëzgjatjes së Marrëveshjes.
- Të bashkëpunoj me stafin e Bashkisë në kryerjen e procedurave të evidentimit në terren të objekteve në proces legalizimi në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.
- Të kryejë veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga Bashkia në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të Palëve. Përfaqësuesit e Palëve nënshkruajnë procesverbalin (*formular informativ*) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm.
- Të trajtojë me prioritet në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.

informojë Bashkinë, pa vonesë, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti për problematikat e hasura gjatë procedurës administrative duke propozuar



zgjidhje në funksion të ecurisë së procesit.

2. Bashkia në zbatim të kësaj Marrëveshje angazhohet të kryejë si vijon:

- a. Të identifikojë dhe hartojë një listë të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale kryesisht me funksion banimi, të ndara sipas nënzonave. Për këtë qëllim Bashkia, harton listën me nënzonat brenda territorit dhe ia dërgon atë ASHK-së.
- b. Të përcjell tek ASHK-ja, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, informacionin e grumbulluar dhe konsoliduar mbi evidentimin e subjekteve dhe ndërtimeve pa leje të zonës/bllokut përkatës, për procesim të mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi.
- c. Të krijojë zyrën përkatëse pranë Bashkisë për të ndihmuar qytetarët në proces (Helpdesk-Njësia e koordinimit pranë Bashkisë) dhe të caktojë stafin pranë Bashkisë që do të përfshihet në administrimin e procesit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, numri i punonjësve përcaktohet nga Bashkia.
- ç. Të identifikojë fondin që do t'i transferohet ASHK-së për stafin e specializuar (sipas Lidhjes 1, bashkëngjitur kësaj Marrëveshje), për qëllim të realizimit të VKM-së. Të ndëmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të VKM-së dhe kësaj Marrëveshjeje. Fondi do të përdoret vetëm për stafin e specializuar që do të vihet në dispozicion të ushtrorëve detyrat pranë ASHK-së gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
- d. Të ofrojë ndihmë dhe informacion nëpërmjet stafit të Bashkisë për subjektet mbi statusin e aplikimit dhe fazën apo ecurinë e procesit, në bllokun gjeografik prioritar të identifikuar nga Bashkia;
- e. Të informojnë dhe sensibilizojnë subjektet në nënzona për procedurat e evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje që do të kryhet nga ASHK-ja, si dhe të asistojë stafin e ASHK-së gjatë kryerjes së procedurave të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje;
- f. Të marrë pjesë në veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga Bashkia në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të Palëve. Përfaqësuesit e Palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm.
- g. Të informojë ASHK-në në lidhje me projektet/ studimet e Bashkisë të miratuara në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 7

Komunikimi midis Palëve

Rakordimi i veprimeve administrative dhe shkëmbimi i informacionit shkëmbimit të informacionit kryhet vetëm në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 8

Përdorimi i informacionit

Informacioni mbledhur, përpiluar, procesuar dhe shkëmbyer midis Palëve sipas



legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdoret vetëm për realizimin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit në mënyrë periodike

1. Përfaqësuesit e Palëve mbajnë kontakt të vazhdueshëm në funksion të zbatimit efektiv të kësaj Marrëveshje. Përfaqësuesit zhvillojnë çdo muaj takime në lidhje me ecurinë e procesit administrativ.
2. Në fund të çdo muaji, çdo përfaqësues harton informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit dhe ia dërgon përkatësisht Drejtorit të ASHK-së dhe Kryetarit të Bashkisë. Drejtori i ASHK-së dhe Kryetari i Bashkisë i dërgojnë çdo muaj Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor informacionin e detajuar mbi ecurinë.

Neni 10

Afati i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe është e vlefshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.
2. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet në formë shkresore dhe me miratimin e të dy Palëve.
3. Secila Palë, nëse për arsye objektive është në pamundësi objektive për të përmbushur angazhimet sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, mund ta zgjidhë atë në mënyrë të njëanshme në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
4. Secila Palë, mund ta zgjidhë Marrëveshjen në çdo kohë, nëse Pala nuk respekton detyrimet e përcaktuara dhe nuk merr masa për rregullimin e pasojave brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim i palës tjetër.

Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

BASHKIA VAU DEJËS

KRYETAR

Kristian Shkëmbi



**AGJENCIA SHTETËRORE
E KADASTRËS**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lorena Goxhobelli

